



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 31.01.2014
Nr.0204-153

PËR: Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës
Islam Husaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës

LËNDA: KONFIRMIMI I LIGJSHMERISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS
SË PEJËS Nr.112-982/2014 të pranuar më datën 31.01.2014

Të nderuar/a,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në nenin 81.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të vendimit Nr. 112-982/2014 të miratuar me datën 23.01.2014 nga Kuvendi i Komunës së Pejës, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit, dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik prodhon efekt të plotë juridik

- Vendim për emërimin e Komisionit për zgjedhjen e Drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në Komunën e Pejës.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësove të Departamenteve të MAPL-së
Arkivot të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 31.01.2014
br.0204-153

Za: Gazmend Muhaxheri, Gradonačelnik opštine Peć
Islam Husaj, Predsedavajući Skupštine opštine Peć

Predmet: Potvrda zakonitosti Skupštine opštine Peć br.112-982/2014 odobreno dana 31.01.2014

Poštovani/e,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave na osnovu nadležnosti i odgovornosti definisano članom 81.4 zakona o lokalnoj samoupravi, kao i uredbe br. 02/2011, o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i Ministarstva dodatak XII, nakon razmatranja odluke br. 112-982/2014 odobreno dana 23.01.2014 od strane Skupštine opštine Peć, Potvrđuje zakonitost akta i procenjuje da isti taj je u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi.

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je kao što sledi :

- Odluka o imenovanju komisije za izbor direktora edukativno-obrazovnih institucija u opštini Peć.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIK OF KOSOVO
RAPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 17 alineja 1 pika h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28. dt.04.qershor 2008"), nenit 4. të Udhëzimit Administrativ për procedurat e zgjedhjes së drejtorit të institucioneve edukativo - arsimore dhe aftësuese Nr.3/2009 të datës 09.Shkurt 2009, dhe nenit 8 të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numer: 09 – 8103 datë 29. shtator 2008, Kuvendi Komunal në Pejë, në takimin e mbajtur me datë 23.janar 2014, në propozim të Kryetarit të Komunës, muarr :

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E DREJTORËVE TË INSTITUCIONEVE EDUKATIVO –
ARSIMORE DHE AFTËSUERE NË KOMUNEN E PEJES

I.EMËROHET, Komisioni për Kordinimin dhe drejtimin e zgjedhjes së drejtorëve të institucioneve edukativo- arsimore dhe aftësuese në Komunën e Pejës, në përbërje si vijon:

1. Mentor Bajri, anëtar – këshilltar i Kuvendit Komunal Pejë,
2. M.sc. Besim Avdimetaj, Drejtorë i Drejtoratit për Arsim, dhe
3. Një përfaqësues nga MASH-i.

II. Komisioni i emëruar obligohet të zhvilloj procedurën dhe të kryej të gjitha veprimet e përcaktuara me nenin 5 dhe dispozitat tjera ligjore të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2009, për Procedurat e zgjedhjes së drejtorëve të institucioneve edukativo – arsimore dhe aftësuese, deri në formulimin e listes kualifikuese: Formularit "D" të cilën duhet t'ja dërgojnë Kryetarit të Komunës për miratim.

III. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi për punën e kryer rreth koordinimit dhe drejtimit të zgjedhjeve të drejtorëve do të përgatit një raport informativ për Kuvendin Komunal.

IV. Për implementimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtorati për Arsim dhe Kryetari i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS
I.Nr.112 – 982/2014 dt.23.Janar 2014.



KRYESUESI,
Dr.Isam Husaj

Vendimi i dërgohet;

- 1x1 Kryetarit të Komunës,
- 1x1. Anëtarve të Komisionit
- 1x1. MAPL
- 1x1. Arkivë.